



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

N: 1126prot

VENDIM

24.03.2023

NR 15 DATË 24/03/2023

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 24/03/2023, analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.73, datë 30.11.2022 Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023” mbështetur nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, neni 22, ndryshuar me ligjin nr.106, datë 30.11.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632, ligji nr.95/2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006, V.K.M nr. 132 datë 07.03.2018 ”Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme” NDERTESA” neni 2, ndryshuar me VKM nr.144 datë 12.02.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr 132 datë 7.03.2018, Për Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndertesa”. Duke u bazuar në domosdoshmerinë për zbatimin korrekt të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë taksën e pasurisë Keshilli Bashkiak:

VENDOSI

1. Te miratoje ndryshimet e pësuara në ligjin 95/2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar për taksën e ndërtesës, pika 8, si më poshtë:

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) Pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) Ndërtesat e banimit që shfrytësohen nga qirramaresi me qera të paliberalizuara;
- c) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare në funksion të veprimtarisë së tyre;
- d) Banesat sociale në pronësi të bashkisë;

e)Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

f)Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

g)Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;

h)Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarim të tyre,që janë të paaftë për punë.

i)Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

j)Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore,të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

2.Te miratoje shtesen e bere per te pasqyruar tarifen e ndotjes per subjektin Albpetrol

Tarife per subjekte jashte bashkise ,fitues ne tendera e investime te medha, me vlere kontrate deri ne 5 milion leke detyrimi 30.000 leke/tender dhe mbi 5 milion leke detyrimi do te jete 50.000 leke/tender,mbi 10.milion tarifa do te jete 100.000 leke. Tarifa per subjektin ALBPETROL eshte 36.000.000 leke.

P.s.per rastet e bashkim operatoresh kjo tarife do të paguhet nga subjekti i autorizuar para mbarimit të kontratës.

Struktura pergjegjese per vjeljen e kesaj tarife eshte drejt.zhvillimit territorit

3.Te miratoje ndryshimet eTarifës së Ndricimit për subjektin Albpetrol i cili nga 20000 duhet të jetë 200000 lekë.Këto ndryshime reflektohen në tabelën si më poshtë:

Bëhet:

Lekë në vit

Tarifa e Ndricimit Rrugor	KUCOVA		KOZARE		PERONDI	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023
I.Familjet		Var.I		Var.I		Var.I
a.Familje ndihme ekonomike,invalid.,veteran ,pensionist i vetmuar	400	400	400	400	400	400
b.Familjet e tjera	1400	1450	900	950	900	950
II. BIZNESI						

a. Biznesi i madh	10000	11000	3500	4500	3500	4500
b. Biznesi I vogel	5000	6000	2200	3200	2200	3200
III. Nd-jet dhe Institucion		11000				
VI.Ndermarrjet me peshe te vecante						
Albpetrol	100000	200000				
Filiali Elektrik	50000	62000				
Ndermarrja e Ujesjellesit	50000	62000				
Filiali Elektrik OST, Kucove	50000	62000				
Sherëood	10 000	10000				

2.Per ndjekjen dhe zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave.

Vendimi Nr. 15 miratua me 16 vota pro, - vota kunder dhe – vota abstenim ,ne prezence te 16 anetareve te Keshillit Bashkiak.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
MIGENA BULLARI**

